



REPUBLIKA E SHQIPERISË
Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale
Drejtoria e Hetim Inspektimit

Nr. 388/ Prot

Tiranë, më 10/04/2013

Lënda : Mbi kundërvajtjen administrative të kontrolluesit, “Velur Spa & Relax”, Tiranë.

VENDIM

Nr. 06, datë 10/04/201

Mbështetur në Ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, Vendimet e Kuvendit të Shqipërisë nr.211, datë 11.09.2008 “Për zgjedhjen e komisionerit për mbrojtjen e të dhënave personale” dhe nr 225, datë 13.11.2008 “Për miratimin e strukturës organike dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të zyrës së Komisionerit për mbrojtjen e të dhënave personale”, pas shqyrtimit të materialit dhe mendimit paraprak të Drejtorisë së Inspektimit në ngarkim të “Velur Spa & Relax”, Tiranë,

KONSTATOVA

Më datë 20/12/2012, nga grupi i inspektimit të Zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, është zhvilluar inspektimi administrativ pranë kontrolluesit, “Velur Spa & Relax”, Tiranë i cili mbledh dhe përpunon të dhëna personale të pacientëve, në ushtrim të qëllimit dhe aktivitetit të tij, me objekt:

➤ **Verifikimi i zbatimit të Urdhërit të Komisionerit Nr.04, datë 05.11.2012, dhënë ndaj kontrolluesit “Velur Spa & Relax”, Tiranë, në lidhje me:**

- 1) Zbatimin e nenit 30 pika I gërma “b” të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008, “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”:

 - Bllokimin e mbledhjes, regjistrimit, përpunimit të të gjithë të dhënave personale të klientes D , si dhe gjithë klientëve të tjerë me qëllim zhvillimin e marketingut të drejtpërdrejtë të mesazheve promovionale, pa pëlqimin e shprehur të klientëve ekzistuesë dhe atyre të rinj.
 - Fshirjen e të dhënave personale të ankuases-kliente, D , si dhe gjithë klientëve të tjerë me qëllim zhvillimin e marketingut të drejtpërdrejtë të mesazheve promovionale, pa pëlqimin e klientëve ekzistuesë dhe atyre të rinj.

- 2) Zbatimin e nenit 6 pika 1 gërma "a" të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", të merren masa të menjëhershme për marrjen e pëlqimit të shprehur të klientëve, mbi mbledhjen, rregjistrimin dhe përpunimin e të dhënave të tyre personale, si dhe pëlqimin e shprehur, nëse ata dëshirojnë marrjen e promocioneve, nëpërmjet një formulari të veçantë fizik, ose faqes së internetit; kjo mënyrë *onlin-e* të jetë e dokumentuar.
- 3) Zbatimin e nenit 5 të ligjit nr.9887, datë 10.03.2008, " Për mbrojtjen e të dhënave personale", paragrafi 1, gërma "c", të mos mblidhen përsëri të dhënat personale mbi gjendjen civile dhe profesionin e klientit, si dhe të hiqen nga Skeda e Klientit, rubrika e "Gjendjes Civile"dhe ajo e "Profesionit".
- 4) Zbatimin e nenit 18, dhe Udhëzimit Nr.16, datë 26.12.2011 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale në tregtimin e drejtpërdrejtë dhe masat e sigurisë", duke modifikuar formularin "Skedë Klienti", duke inkorporuar në të, informimin e klientit në lidhje me mbrojtjen e të dhënave personale.

Nga kontrolli administrativ, lidhur me përmbushjen e detyrimeve të dalta nga ky rekomandim, kontrolluesi "Velur Spa & Relax", Tiranë rezultoi si vijon:

1-Kontrolluesi, "Velur Spa & Relax", Tiranë, ka përmbushur të gjitha pikat e Urdhërit Nr.04, datë 05.11.2013, i Komisionerit për Mbrojtjes e të Dhënave Personale, **përveç paragrafit të katërt të këtij urdhri, sipas të cilit,**

Kontrolluesi, "Velur Spa & Relax". Tiranë, në zbatim të nenit 18, dhe Udhëzimit Nr.16, datë 26.12.2011 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, në tregtimin e drejtpërdrejtë dhe masat e sigurisë", duhej të modifikojë formularin "Skedë Klienti", duke inkorporuar në të, informimin e klientit në lidhje me mbrojtjen e të dhënave personale.

Sa më sipër, ligjërisht vlerësoj se, kontrolluesi "Velur Spa & Relax", Tiranë, ka përmbushur pjesën më të madhe të detyrimeve që rrjedhin nga Urdhëri Nr.04, datë 05.11.2012, i Komisionerit për Mbrojtjes e të Dhënave Personale, por paragrafi 4 i këtij urdhri, i cili nuk është përmbushur, është një pjesë e rëndësishme, i cili konsiston në informimin e klientit, ndaj është detyruese forma e shkruar e këtij informimi.

- Moszbatimi tërësisht i paragrafit 4, të Urdhërit Nr.04, datë 05.11.2012, të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, e ngarkon kontrolluesin me përgjegjësi administrative të parashikuar në nenin 39 pika 1, gërma "b", të ligjit nr.9887, datë 10.3.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", ku parashikohet dënimi me gjobë nga 10.000 deri në 30.000 lekë.

Për zgjedhjen e masës së gjobës, Komisioneri ka parasysh shkallën e njohjes dhe masat që keni marrë për implementimin e ligjit nr.9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale".

Nisur sa më sipër, në zbatim të neneve 30/2, 39/1,4; 40 e 41, të Ligjit nr.9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", 107-109 të K.Pr.Administrative, si dhe Nenit 18/a, c të Ligjit Nr. 10279, datë 20.05.2010 "Për Kundërvajtjet Administrative".

V E N D O S A

1. Dënimin e Kontrolluesit, "Velur Spa & Relax", Tiranë, me gjobë, si më poshtë:

I/a. Bazuar në nenin 39 pika 1, gërma "b", të ligjit nr.9887, datë 10.3.2008, "Për mbrojtjen e të dhënave personale, me vlerën 50.000 (pesëdhjetëmijë) lek;

2. Të përmbushet, detyrimi ligjor që buron nga Urdhëri Nr.04, datë 05.11.2012, i Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, dhe konkretisht, në lidhje me paragrafin 4, të parashikuar në këtë urdhër, në zbatim të nenit 18 të Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar, "Detyrimi për informim".
3. Detyrimet që rrjedhin nga ky vendim të përmbushen brenda një afati 10 (dhjetë) ditor. Me plotësimin e këtyre detyrimeve të njoftohet me shkrim pranë Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale;
4. Gjoha, arkëtohet nga kundërvajtësi në Buxhetin e Shtetit, jo më vonë se 30 ditë nga komunikimi i këtij vendimi;
5. Me kalimin e këtij afati, ky vendim standërrohet në titull ekzekutiv dhe ekzekutohet në mënyrë të detyrueshme nga zyra e përmbarimit;
6. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor, Tiranë, brenda 30 ditëve nga data e njoftimit.

Ky vendim u dha sot më datë, 08.04.2013.

Komisioneri

Flora Çabej (Pogaçe)

Në mungesë dhe me porosi

Këshilltari

Besnik Petrela

